

03.10.2023

Njoftim për Shtyp

Zhvillohet mbledhja e rradhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë

Në institucionin e Avokatit të Popullit, ditën e hënë, datë 02.10.2023, ora 16.00 u zhvillua mbledhja e rradhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë.

Pjesëmarrës në mbledhje ishin Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca - kryetar, z. Sandër Simoni – zëvendëskryetar dhe anëtarët: z. Shaban Sinani, z. Ilir Dode dhe z. Maksim Haxhia.

Të pranishëm në mbledhje, me statusin e vëzhguesit, ishin gjithashtu dhe përfaqësues nga misionet ndërkombëtare në Shqipëri, përkatësisht nga projekti EU4Justice dhe nga OPDAT.

Në përputhje me rendin e ditës të shpërndarë paraprakisht, kryetari informoi fillimisht për komunikimin me institucionet e tjera.

Më pas Komisioni kaloi në verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të kandidatëve.

Pas shqyrtimit Komisioni vendosi:

1. Të dërgohet shkresë për informacion në organet tatimore, në lidhje me shlyerjen nga kandidatët të detyrimeve tatimore për 15 vitet e fundit, në zbatim të nenit 19, pika 3, gërma “ç” e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
2. Kryerjen *ex officio* të procesit të verifikimit të të dhënave të kandidatëve, sipas formularëve të vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pas komunikimit me Prokurorinë e Përgjithshme.
3. Kthimin e akteve kandidatit Sabri Hoxha, pasi aplikimi i tij është dërguar jashtë afatit të parashikuar në ligj.
4. Për kandidatët e tjerë do të vijojë hetimi administrativ, pas verifikimit të të dhënave në formularët e dorëzuar.

Komisioni vendosi që mbledhja e rradhës të zhvillohet ditën e martë, datë 03.10.2023, ora 16.00, në ambientet e institucionit të Avokatit të Popullit, ku do të vazhdohet me shqyrtimin e verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore nga kandidatët, si dhe do të zhvillohet një takim me një ekspert ndërkombëtar për të diskutuar mbi detajimin e kriterëve profesionale dhe morale, si dhe caktimin e peshës specifike të tyre, për renditjen e kandidatëve.